



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:089888
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05755013

PPP.nr.28/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, K.R.M, "Ekoregjioni", Sh.a. me seli në Prizren rr "....." nr., Nesia Operative, kundër debitorit D.B., nga Prizreni, rr"",, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.750/2017 të datës 27.06.2017 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Saranda Kuqi nga Suhareka, e ku tash procedura zbatohet nga përmbartuesi privat Mehdi Reshani nga Prizreni me numër P.nr.619/2022, jashtë seancës dëgjimore, më datë 30.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit D.B., nga Prizreni, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.750/2017 të datës 27.06.2017 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Saranda Kuqi nga Suhareka, dhe i njëjti Urdhër për përmbartim, ANULOHET – Lihet jashtë fuqie, derisa propozimi për përmbartim i kreditorës së përmbartimit, K.R.M."Ekoregjioni" me seli në Prizren, REFUZOHET si i pa bazuar.

II. Shpenzimet e procedurës së përmbartimit bien në ngarkim të kreditorit.

A r s y e t i m

Organi përmbartues, përmbartuesi privat, Saranda Kuqi nga Suhareka, me Urdhërin për përmbartim, P.nr.750/2017 të datës 27.06.2017 ka lejuar propozimin për përmbartim të kreditorës K.R.M."Ekoregjioni" me seli në Prizren, të paraqitur kundër debitorit D.B., nga Prizreni, për përmbartimin e dokumentit të besueshëm, kartela e konsumatorit me shifër - 091179 për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 578.65 € në emër të shpenzimeve komunale për mbeturina dhe shpenzimeve të caktuara të përmbartimit në shumën prej 46,02 eurove.

Kundër Urdhërit të lartë cekur për përmbartim, debitori në afatin ligjor ka paraqitur prapësim, e me propozim që që të aprovohet prapësimi dhe propozimi për përmbartim i përmbartuesit privat P.nr.750/2017 i datës 27.06.2017 të abrogohet për shkak të arsyeve të cekura dhe parashkrimit.

Përgjigje në prapësim, nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Themelore në Prizren, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe atë për këto arsye:

Me shikimin në shkresat e lëndës së përmbartimit, P.nr.750/2017 të Zyrës së Përmbartuesit privat, gjykata si organ kompetent për vendosje për prapësimet e ushtruar kundër urdhërave për përmbartim të përmbartuesit privat, si në rastin konkret, vërtetoi faktin se kreditoja e përmbartimit, propozimin për përmbartim e ka bërë për përmbartimin e dokumentit të besueshëm të lartëcekur të përmbartimit – kartela e konsumatorit me shifër -091179, për shkak të detyrimit të lartëcekur në të holla dhe i lejuar me Urdhërin e lartë cekur për përmbartim e me propozim të mjeteve gjegjëse të përmbartimit të parapara në LPP për realizimin e detyrimit në të holla.

Në kuadër të prapësimit si mjet i rregullt juridik në procedurën e përmbartimit, bëhet fjalë në nenin 69 të LPP-së e në të cilin, thuhet: *''Prapësimi mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të organit përmbartues me të cilin përmbartimi është i lejuar Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim në Gjykatën themelore Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet''* derisa për shkaqet e parapara e për prapësim, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së e në të cilin, thuhet: *'' Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohet vetëm nëse : ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbartimi... ''*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin e besueshëm të përmbartimit, por se nga gjendja e shkresave të lëndës del se propozimi për përmbartim i palës kreditore, është bërë pas skadimit të afatit kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet në tërësi përmbartimi e në këtë rast të kartela e konsumatorit me shifër -091179, nga shërbimi komunal i mbeturinave si dokument i besueshëm i përmbartimit e me këtë del se pretendimi i palës debitore se kemi parashkrim të borxhit i theksuar në prapësimin e tij të ushtruar kundër Urdhërit për përmbartim, P.nr.750/2017 të dt.27.06.2017 të përmbartuesit privat, është tërësisht i bazuar, pasi që pala debitore siq shihet në kartelën e konsumatorit gjatë vitëve kalendarike, nuk ka bërë asnjë pagesë e që të kishte ndërprerje të afatit të parashkrimit sikurse edhe me bërjen e propozimit për përmbartim nga pala kreditore tek me dt.27.06.2027 e me këtë del se në rastin konkret, ekziston njëri nga shkaqet që parashihet në nenin 71 par.1 pika 4 të LPP-së, lidhur me nenin 341, dhe nenin 360 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe e cili shkak e pengon përmbartimin e tërësishëm të kredisë - detyrimit në të holla në këtë çështje juridike të përmbartimit – skadimin e afati kohor për të kërkuar përmbartimin, andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë vendosi e me gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 3, 13, 73, të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.28/2024
Datë 30.05.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

Numri i lëndës: 2024:089888
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05755013

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.